



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVO BAR ASSOCIATION

Në bazë të nenit 21, paragrafi 1 dhe nenit 41, paragrafi 3, nënparagrafi 3.3 të Ligjit nr. 04/L-193 për Avokatinë, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 20, të datës 31 maj 2013 dhe nenit 87, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës, Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës, në seancën e mbajtur më datë 27 dhjetor 2025, miraton këtë:

RREGULLORE PËR TARIFAT E AVOKATISË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen tarifat për shërbimin e avokatit dhe kompensimi i shpenzimeve për shërbimin e avokatit.

Neni 2

1. Kur avokati ushtron veprimtari profesionale jashtë territorit të Republikës së Kosovës, ai mund të inkasojë shpërblimin dhe kompensimin e shpenzimeve, sipas tarifës së avokatëve të shtetit përkatës.
2. Kur avokati kryen punë për një subjekt të huaj, fizik apo juridik, shpërblimi dhe kompensimi i shpenzimeve mund të përcaktohen sipas kësaj Rregulloreje ose sipas dispozitave përkatëse të tarifave të avokatëve të shtetit nga i cili rrjedh subjekti për të cilin kryhet puna.
3. Dispozitat mbi pagesat sipas tarifave të avokatëve të huaj dhe kompensimin e shpenzimeve të tyre mund të aplikohen edhe për subjektet vendase, fizike ose juridike, kur shërbimi juridik ofrohet jashtë territorit të Republikës së Kosovës.
4. Avokati mund të aplikojë tarifat dhe mund të kërkojë kompensimin e shpenzimeve sipas tarifave të avokatëve të huaj edhe në rastet kur shërbimi kryhet jashtë vendit në formë të shkruar nga distanca.

Neni 3

Kur avokati angazhohet nga një subjekt fizik ose juridik për përfaqësim apo mbrojtje, si dhe për ofrimin e ndihmës juridike në mënyrë të vazhdueshme, avokati mund të lidhë kontratë me klientin, me të cilën përcaktohet shpërblimi në shumë fikse mujore, sipas marrëveshjes.

Neni 4

1. Pavarësisht dispozitave që përcaktojnë lartësinë e tarifave sipas kësaj Rregulloreje, avokati dhe klienti apo personi i autorizuar i klientit, mund të kontraktojnë shpërblimin për shërbimet e avokatit dhe kostot tjera të shërbimit me marrëveshje të lirë ndërmjet tyre.
2. Marrëveshja sipas paragrafit 1 të këtij neni nënkupton, por nuk kufizohet në:
 - a) Marrëveshjen – kontratën me shkrim ndërmjet avokatit dhe klientit ose personit të autorizuar, apo
 - b) Faturës së lëshuar nga avokati, të pranuar dhe të nënshkruar nga klienti apo personi i autorizuar nga klienti.

II. KOMPENSIMI I SHPENZIMEVE

Neni 5

1. Për punën e kryer jashtë selisë së zyrës së avokatit, avokatit i takon kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit, kompensimi për mungesë nga zyra, mëditja, si dhe shpenzimet tjera që krijohen gjatë ofrimit të shërbimeve.
2. Përveç nëse avokati dhe klienti janë dakorduar ndryshe, avokatit gjithmonë i takon kompensimi i shpenzimeve si në vijim:
 - a) për udhëtim në relacionet ndër-urbane, në lartësi të çmimit të udhëtimit që aplikon auto-taksi,
 - b) për udhëtime në relacionet urbane, në lartësi të çmimit të udhëtimit që aplikon auto-taksi,
 - c) për përdorimin e automjetit personal në lartësi të 30% të vlerës së karburantit më të shtrenjtë për çdo kilometër të kaluar,
 - d) për mungesë nga zyra, kompensim në lartësi prej 25% të shpërblimit të paraparë me këtë Rregullore.
3. Mëditja dhe shpenzimet e fjetjes i pranohen avokatit në lartësi dhe sipas kriterëve të përcaktuara me dispozitat ligjore apo nënligjore që zbatohen për gjyqtarët.

III. PAGESA

Neni 6

1. Pagesat e shpërblimit dhe shpenzimeve mund të bëhen me para të gatshme ose përmes llogarisë bankare.
2. Avokati mund të kërkojë që pagesa të kryhet edhe para ofrimit të shërbimit, përfshirë pagesën në formë të paradhënies.
3. Me kërkesë të klientit, avokati pajisë me faturë klientin për shërbimin e realizuar.
4. Në rast se subjekti i avokatit, i regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK), është deklarues i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), TVSH-ja për shërbimet e avokatit llogaritet mbi tarifën e përcaktuar sipas kësaj Rregulloreje.

Neni 7

Shpërblimi për shërbimin e kryer përcaktohet sipas tarifës që është në fuqi ose sipas tarifës që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së shërbimit. E drejta për të përcaktuar se cila tarifë do të zbatohet, ajo në fuqi në kohën e kryerjes së shërbimit apo ajo në fuqi në kohën e pagesës, i takon ekskluzivisht avokatit.

IV. SHPËRBLIMI PËR SHËRBIMIN E AVOKATIT

1. PROCEDURA PENALE

Mbrojtja e të pandehurit/akuzuarit

Numri tarifor 1.

Për çdo angazhim të avokatit për klientin, përfshirë, por pa u kufizuar në, procedimin pranë Policisë, seancat dëgjimore pranë Prokurorisë, procedurën paraprake dhe procedurën përgatitore ndaj të miturit, pjesëmarrjen në shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë, shqyrtimin gjyqësor, stadin e ekzekutimit të sanksionit penal, këqyrjen e vendit të ngjarjes, rikonstruksionet, ekspertimet, vizitat në institucionet korrektuese, administrimin e çështjes, si dhe të gjitha veprimet e tjera procedurale që ndërmerren në zyrë ose pranë institucioneve publike apo private, avokatit i takon shpërblimi si vijon:

- a) për çështje penale në kompetencë të Departamentit të Përgjithshëm, në lartësi prej 240 euro.
- b) për çështje penale në kompetencë të Departamentit të Krimeve të Rënda apo për të Mitur, për vepra penale ku parashihet dënimi deri në 10 vjet burgim, në lartësi prej 300 euro.
- c) për çështje penale në kompetencë të departamentit të Krimeve të Rënda apo për të Mitur, për vepra penale ku parashihet dënimi me mbi 10 vjet burgim, në lartësi prej 400 euro.

- d) për çështje penale në kompetencë të Departamentit Special, në lartësi prej 500 euro.

Për procedimet e caktuara që nuk mbahen ose shtyhen pa fajin e avokatit, avokatit i takon shpërblimi në lartësi prej 50% të shpërblimit të paraparë sipas numrit tarifar 1 të kësaj Rregulloreje.

Përfaqësimi i të dëmtuarit

Numri tarifar 2

Për përfaqësimin e të dëmtuarit në çështje penale, avokatit i takon përshtatshmërisht shpërblimi i përcaktuar sipas numrit tarifar 1 të kësaj Rregulloreje.

Përpilimi i parashtresave penale

Numri tarifar 3

1. Për përpilimin e kallëzimit penal, avokatit i takon shpërblimi i përcaktuar sipas numrave tarifarë 1 dhe 2 të kësaj Rregulloreje, varësisht nga statusi procedural i klientit.
2. Për përpilimin e të gjitha parashtresave të tjera në procedurën penale, avokatit i takon 50% e shpërblimit të përcaktuar sipas numrave tarifarë 1 dhe 2 të kësaj Rregulloreje.

Mjetet juridike në çështje penale

Numri tarifar 4.

Për përpilimin e mjeteve juridike në procedurë penale, avokatit i takon shpërblimi në lartësi të dyfishit të shpërblimit të paraparë sipas numrit tarifar 1 dhe 2 të kësaj Rregulloreje, varësisht nga statusi procedural i klientit.

Numri tarifar 5

Për përpilimin e ankesës kundër aktvendimit për caktimin apo vazhdimin e paraburgimit, kundër aktvendimit për refuzimin e kërkesës për rishikimin e procedurës, si dhe kundër çdo aktvendimi tjetër në procedurën penale, avokatit i takon shpërblimi në lartësi të përcaktuar sipas numrit tarifar 1 të kësaj Rregulloreje.

2. PROCEDURAT CIVILE E TË TJERA

Përpilimi i parashtresave

Numri tarifar 6

1. Për përpilimin e parashtresave me të cilat inicohet ose zhvillohet procedura civile, kontestimore, jo kontestimore, ekonomike, administrative, tatimore, doganore, si dhe çdo procedurë para gjykatës apo organit tjetër kompetent, avokatit i takon shpërblimi si vijon:

➤ **Sipas vlerës së çështjes juridike:**

- a) për çështje juridike, vlera e të cilave nuk kalon shumën e kontestit të vlerës së vogël, shpërblim me bazë fillestare prej 120 euro;
- b) për çështje juridike vlera e të cilave kalon shumën e kontestit të vlerës së vogël deri në vlerën prej 10.000 euro, shpërblim në lartësi prej 160 euro;
- c) për çështje juridike vlera e të cilave është 10.000 euro ose më e lartë, shpërblim me bazë fillestare prej 320 euro;
- d) për çështje juridike vlera e të cilave është 100.000 euro ose më e lartë, shpërblim me bazë fillestare prej 500 euro;

➤ **Çështje të veçanta, pavarësisht nga vlera e kontestit:**

- e) për konteste të pengim posedimit, shpërblim me bazë fillestare prej 160 euro;
 - f) për procedurë shkurorëzimi me marrëveshje, shpërblim me bazë fillestare prej 160 euro,
 - g) për procedurë shkurorëzimi me padi, me ose pa kërkesë për besimin e fëmijëve dhe caktimin e kontributit për mbajtje dhe ushqim, shpërblim me bazë fillestare prej 240 euro.
 - h) për çështje juridiko-administrative pranë institucioneve shtetërore ose personave juridik, kur çështja nuk ka vlerë të përcaktuar monetare, shpërblimi llogaritet mbi bazën tarifore prej 320 euro.
2. Për çështjet juridike që zhvillohen në Gjykatën Komerciale të Kosovës, si dhe për çështjet që trajtohen në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, shpërblimi me bazë fillestare përcaktohet në shumën prej 500 euro.
 3. Për përpilimin e përgjigjes në padi, përgjigjes në prapësim, prapësimi kundër aktvendimit për lejimin e përmbarimit, masës së sigurisë apo masës së përkohshme, si dhe për parashtresat e tjera, avokatit i takon shpërblimi në lartësi të përcaktuar sipas paragrafit 1 të këtij numri tarifar.
 4. Për përpilimin e këtyre akteve juridike në Gjykatën Komerciale të Kosovës dhe në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, avokatit i takon shpërblimi në lartësi të përcaktuar sipas paragrafit 2 të numrit tarifar 6.
 5. Nëse në një padi ose propozim janë përfshirë më shumë kërkesa kumulative, avokatit i takon shpërblimi i plotë për parashtresën e përpiluar, me shtesë prej 50%.

Përfaqësimi në seanca për çështje civile dhe të tjera

Numri tarifor 7

1. Për përfaqësim në seanca për çështje civile dhe të tjera, avokatit i takon shpërblimi si vijon:
 - për çdo seancë gjyqësore, shpërblimi në lartësi të shpërblimit të paraparë për parashtresat inicuese, sipas numrit tarifor 6 të kësaj Rregulloreje,
 - për çdo seancë të shtyrë ose të mosmbajtur pa fajin e avokatit, shpërblimi në lartësi prej 50% të shumës, sipas numrit tarifor 6 të kësaj Rregulloreje,
2. Shpërblimi si në paragrafi 1. të këtij numri tarifor i takon avokatit edhe për administrimin e çështjes, asistimin gjatë ekspertimit, këqyrjen e vendit të ngjarjes, si dhe për veprimet tjera procedurale që ndërmerren jashtë ndërtesës së Gjykatës.
3. Për përpilimin e parashtresave dhe përfaqësim në seanca për çështje civile që i referohen arbitrazhit si dhe kontestet me element të huaj, shpërblimi i përcaktuar sipas numrave tarifor 6 dhe 7 rritet për 100%.

Përfaqësimet në procedurat e tjera

Numri tarifor 8

1. Në çështjet para arbitrazheve, organeve të ndërmjetësimit, në procedurat administrativo-fiskale, doganore, kundërvajtëse ose disiplinore, si dhe para bordeve përkatëse, apo në procedura që nuk janë të parashikuara shprehimisht me këtë Rregullore, zbatohen shpërblimet në lartësitë e përcaktuara sipas numrave tariforë 6 dhe 7 të kësaj Rregulloreje.
2. Për mbrojtjen e të pandehurit ose për përfaqësimin në procedura disiplinore apo kundërvajtëse, kur çështja nuk ka vlerë monetare të përcaktuar, avokatit i takon shpërblimi në shumën prej 120 €.

Mjetet juridike në çështjet civile dhe të tjera

Numri tarifor 9

1. Për përpilimin e mjeteve juridike në çështjet civile dhe të tjera, avokatit i takon shpërblimi në lartësi të dyfishit të shpërblimit të paraparë për parashtresat me të cilat iniciohet procedura, në përputhje me numrin tarifor 6 të kësaj Rregulloreje (padi, kërkesë, prapësim dhe akte tjera përkatëse).
2. Për mjetet juridike që paraqiten në Gjykatën Komerciale të Kosovës dhe në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, zbatohet shpërblimi në lartësi të dyfishit të shpërblimit të përcaktuar sipas numrit tarifor 6.2 të kësaj Rregulloreje.

Përfaqësimi i më shumë palëve

Numri tarifor 10

1. Kur avokati përfaqëson dy apo më shumë palë, ose nëse si palë kundërshtare ka më shumë persona, për përpilimin e parashtrësave dhe për përfaqësimin në seanca gjyqësore, avokatit i takon shpërblimi i rritur për 50% për palën e dytë dhe secilën të mëtejshme, por jo më shumë se deri në trefishin e shumës së paraparë me këtë Rregullore.
2. Në rastet kur sipas numrit tarifor 6.1, vlera e kontestit është mbi 100.000 euro, rritja nga paragrafi 1 i këtij neni llogaritet në lartësi prej 25%.

Përfaqësimi jashtë orarit të punës

Numri tarifor 11

Për punën që avokati e kryen jashtë orarit të rregullt të punës të organit para të cilit procedohet çështja, si dhe gjatë ditëve të fundjavës ose të festave zyrtare, shpërblimi i paraparë me këtë Rregullore rritet për 50%.

3. PËRPILIMI I DOKUMENTEVE

Numri tarifor 12

1. Për përpilimin e dokumenteve për punë juridike njëanshme, dyanshme ose shumanshme, ndërmjet të gjallëve ose për rast vdekjeje, përfshirë kontrata, ujdj, testamente, legate dhe akte të tjera të ngjashme, avokati mund të aplikojë shpërblimin e paraparë sipas numrit tarifor 6 të kësaj Rregulloreje, ose ta llogarisë shpërblimin në mënyrë proporcionale me vlerën e tregut të pasurisë që përbën objektin e punës juridike, por jo më shumë se 2% e asaj vlere.
2. Kur objekt i çështjes juridike janë dhëniet e përkohshme ose periodike, si qiraja, renta dhe të ngjashme, vlera e tregut përcaktohet duke u bazuar në shumën e dhënieve për periudhën prej 1 (një) viti.
3. Për përpilimin e dokumenteve për punë juridike kur vlera monetare nuk është e përcaktuar, avokatit i takon shpërblimi përshtatshmërisht, në lartësinë e paraparë sipas numrit tarifor 6.1. nënpika e. f. g. dhe 2 të tarifës së kësaj Rregulloreje.

4. DISPOZITAT E PËRBASHKËTA

Këshillat me mendimet juridike

Numri tarifor 13

1. Për dhënien e këshillës juridike verbale ose mendimit juridik verbal, avokatit i takon shpërblimi në lartësi prej 30%, ndërsa në rastet më të ndërlikuara në lartësi prej 50%, të shpërblimit të paraparë sipas numrave tariforë 1, 2 dhe 8 të kësaj Rregulloreje.
2. Për këshillë juridike ose mendim juridik në formë të shkruar, avokatit i takon shpërblimi i përcaktuar sipas numrit tarifor 6 të kësaj Rregulloreje.

Mbrojtja dhe përfaqësimi në shqyrtime, seanca e tjera

Numri tarifor 14

1. Për mbrojtje dhe përfaqësim në shqyrtime, seanca, këqyrje në vend, ekspertime, si dhe për të gjitha veprimet që organi kompetent i zbaton brenda ndërtesës ku ka selinë ose jashtë saj, avokatit i takon shpërblim shtesë për çdo orë të filluar, në lartësi prej 30% të shumës me bazë fillestare sipas tarifës përkatëse të kësaj Rregulloreje, duke llogaritur kohën nga momenti i caktuar për fillimin e veprimit deri në përfundimin e tij.
2. Avokati ka të drejtë në shpërblimin sipas paragrafit 1 të këtij numri tarifor edhe kur asiston në mbledhje të organeve drejtuese të personave juridik, bordeve në veprime të ndërmjetësimit, si dhe në takime me persona fizik ose juridik, kur në këto takime diskutohen çështje faktike dhe juridike.
3. Për konsultime me të pandehurin, të akuzuarin ose të gjykuarin, si dhe me klientin në çështje civile dhe të tjera, avokatit i takon shpërblimi në lartësi prej 50% të shpërblimit të përcaktuar sipas numrave tariforë 1, 7, 8 dhe 10 të kësaj Rregulloreje.

Shqyrtimi i shkresave

Numri tarifor 15

Avokatit i takon shpërblimi si vijon:

- a) për shqyrtimin e shkresave, në lartësi prej 50 % të shpërblimit të paraparë me numrin tarifor 1. 7. dhe 8. të kësaj Rregulloreje;
- b) për shikimin në librat kadastralë dhe në librat të tjerë publik, për nxjerrjen ekstrakteve nga librat publik, si dhe për sigurimin e vërtetimit të plotfuqishmërisë dhe të përmbareshmërisë së vendimeve gjyqësore ose administrative, avokatit i takon shpërblimi në lartësi prej 50% të shpërblimit të përcaktuar sipas numrave tarifor 1, 2, 6 dhe 8 të kësaj Rregulloreje.

Shkresat dhe vërejtjet

Numri tarifor 16

Për përpilimin e vërejtjeve ose parashtresave drejtuar palës kundërshtare në procedurë, me të cilat kërkohet përmbushja e ndonjë prestitimi apo përmbajtja nga ndonjë veprim, në çështjet që janë me vlerë, avokatit i takon shpërblimi në lartësi prej 50% nga shpërblimi nga pika 1. e numrit tarifor 7 të kësaj Rregulloreje.

Vlera paushalle për veprime sporadike

Numri tarifor 17

Avokati ka të drejtë të inkasojë shpërblim paushall në lartësi prej 30% të shumës së përgjithshme të paraparë për veprimin përkatës sipas numrit tarifor bazë, ndërsa për veprimet e përcaktuara sipas numrit tarifor 12, shpërblimi llogaritet në mënyrë proporcionale në përqindje.

V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 8 Zbatimi analog

Për veprimet që nuk janë të parashikuara shprehimisht me këtë Rregullore, dispozitat e saj zbatohen në mënyrë të përshtatshme.

Neni 9 Publikimi i tarifave

Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës, në përputhje me këtë Rregullore, harton dhe publikon ekstraktin tabelar të tarifave, i cili përbën shtojcë përbërëse dhe pjesë integrale të kësaj Rregulloreje. Me rastin e hartimit të ekstraktit tabelar, shumat e përcaktuara sipas numrave tarifar mund të rrumbullaksohen, ashtu që vlerat nga 0,01 euro deri në 0,99 euro të mos pasqyrohen.

Neni 10 Përgjegjësia disiplinore për shkelje të Rregullores

Veprimet në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje përbëjnë shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokatisë dhe trajtohen sipas dispozitave normative të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Neni 11 Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për Tarifat e Avokatëve e miratuar më datë 18 mars 2017, e cila ka qenë në fuqi nga data 18 mars 2017.

Neni 12 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës, më datë 27 dhjetor 2025 dhe zbatohet nga data 01.01.2026.


Besnik R. BERISHA
Kryetar i OAK
Prishtinë, 27 dhjetor 2025



TARIFA E AVOKATËVE TË KOSOVËS

FORMA TABELARE

	PROCEDURA PENALE - KAPITULLI (IV)				
<u>Referuar nr. tarifar 1 dhe 2</u>		Baza	30 % për çdo orë të filluar	Paushall i 30 %	Gjithsejtë:
<i>Mbrojtja e të dyshuarit/ pandehurit dhe përfaqësimi i të dëmtuarit</i>	Për vepër penale nga kompetenca e Departamentit të përgjithshëm të Gjykatës/Prokurorisë.	240 €	72 €	93,60 €	405.60 €
	Për vepër penale nga kompetenca e Departamentit të për krime të rënda dhe të mitur të Gjykatës/Prokurorisë për vepër penale për të cilat parashihet dënimi deri në dhjet vjet burg	300 €	90 €	117 €	507 €
	Për vepër penale për të cilat parashihet dënimi dhjet e më shumë vjet burg dhe krimet e rënda, neni 22 i KPPRK	400 €	120 €	156 €	676 €

<u>Referuar nr. tarifar 3.1 lidhur me nr. tarifar 5</u>		Baza	P. 30 %	Gjithsejtë:
<i>Përpilimi i aktit iniciues të procedurës penale/ Kallëzimi penal dhe ankesave ndaj vendimeve procedurale</i>	Për vepër penale nga kompetenca e Departamentit të përgjithshëm të Gjykatës /Prokurorisë.	240 €	72 €	312 €
	Për vepër penale nga kompetenca e Depart. të krimeve të rënda dhe për të mitur të Gjykatës /Prokurorisë, për v.p. për të cilat parashihet dënimi deri në dhjet vjet burg	300 €	90 €	390 €
	Për vepër penale për të cilat parashihet dënimi dhjet e më shumë vjet burg dhe krimet e rënda – neni 22 i KPPK.	400 €	120 €	520 €

<u>Referuar nr. tarifar 3.2 lidhur me nr. tarifar 3.1</u>		Baza e 3.1	-50%	Gjithsejtë:
<i>Përpilimi i parashtrësve tjera penale (kërkesave, kundërshtime etj)</i>	Për vepër penale nga kompetenca e Departamentit të përgjithshëm të Gjykatës /Prokurorisë.	312 €	156 €	156 €
	Për vepër penale nga kompetenca e Depart. të krimeve të rënda dhe për të mitur të Gjykatës /Prokurorisë, për v.p. për të cilat parashihet dënimi deri në dhjet vjet burg	390 €	195 €	195 €
	Për vepër penale për të cilat parashihet dënimi dhjet e më shumë vjet burg dhe krimet e rënda – neni 22 i KPPK.	520 €	260 €	260 €

<u>Referuar nr. tarifar 4 lidhur me nr. tarifar 1 dhe 2</u>		Baza	Dyfishi	Gjithsejtë:
Përpilimi i mjeteve juridike, ndaj vendimeve meritore	Për vepër penale nga kompetenca e Departamentit të përgjithshëm të Gjykatës /Prokurorisë.	405.60 €	405.60 €	811 €
	Për vepër penale nga kompetenca e Depart. të krimeve të rënda dhe për të mitur të Gjykatës /Prokurorisë, për v.p. për të cilat parashihet dënimi deri në dhjet vjet burg	507 €	507 €	1,014 €
	Për vepër penale për të cilat parashihet dënimi dhjet e më shumë vjet burg dhe krimet e rënda – neni 22 i KPPK.	676 €	676 €	1,352 €

PROCEDURA CIVILE DHE TË TJERA - KAPITULLI (IV)					
<u>Referuar nr. tarifar 6.1 (a, b, c, d) dhe nr. 10</u>	Procedura civile dhe të tjera, me vlera monetare të caktuara	mbi një palë	Baza	Paushall i 30 %	Gjithsejtë
Përpilimi i kërkesave, padive, propozimeve, prapësimeve, përgjigjeve	<i>Kontest i vlerës së vogël</i>		120 €	36 €	156 €
	Për paditësin/të paditurin e dytë:	50%	180 €	54 €	234 €
	Për paditësin/të paditurin e tretë:	50%	240 €	72 €	312 €
	Për paditësin/ të paditurin e katër:	50%	300 €	90 €	390 €
	Për paditësin/ të paditurin e pestë:	50%	360 €	108 €	468 €
	<i>Kontest me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri në 10.000 €</i>		160 €	48 €	208 €
	Për paditësin / të paditurin e dytë:	50%	240 €	72 €	312 €
	Për paditësin / të paditurin e tretë:	50%	320 €	96 €	416 €
	Për paditësin / të paditurin e katër:	50%	400 €	120 €	520 €
	Për paditësin / të paditurin e pestë:	50%	480 €	144 €	624 €
	<i>Kontesti me vlerë prej 10.000 € e më lartë</i>		320 €	96 €	416 €
	Për paditësin / të paditurin e dytë:	50%	480 €	144 €	624 €
	Për paditësin / të paditurin e tretë:	50%	640 €	192 €	832 €
	Për paditësin / të paditurin e katër:	50%	800 €	240 €	1,040 €
	Për paditësin / të paditurin e pestë:	50%	960 €	288 €	1,248 €
	<i>Kontesti me vlerë prej 100.000 € e më lartë</i>		500 €	150 €	650 €
	Për paditësin / të paditurin e dytë:	25%	625 €	187,50 €	812,50 €
	Për paditësin / të paditurin e tretë:	25%	750 €	225 €	975 €
	Për paditësin / të paditurin e katër:	25%	875 €	262.50 €	1,137.50 €
	Për paditësin / të paditurin e pestë:	25%	1,000 €	300 €	1,300 €

<u>Referuar nr. tarifar 6.1 (e, f, g, h) dhe nr. 10</u>	Procedura civile dhe të tjera, me vlera monetare të pacaktuara	mbi një palë	Baza	Paushall i 30 %	Gjithsejtë
Përpilimi i padive për pengim posedim,	Për paditësin-propozuesin / të paditurin-propozuesin e parë:		160 €	48 €	208 €

<i>propozimeve të ndryshme, përgjigjeve në padi dhe propozimeve</i>	Për paditësin-propozuesin / të paditurin-propozuesin e dytë:	50%	240 €	72 €	312 €
	Për paditësin-propozuesin / të paditurin-propozuesin e tretë:	50%	320 €	96 €	416 €
	Për paditësin-propozuesin / të paditurin-propozuesin e katër:	50%	400 €	120 €	520 €
	Për paditësin-propozuesin / të paditurin-propozuesin e pesë:	50%	480 €	144 €	624 €
<i>Përpilimi i të gjithë padive dhe përgjigjeve në padi tjera, pa vlera monetare të caktuara, për kontestetestet tjera në Gjykatë</i>	Për paditësin / të paditurin e parë:		240 €	72 €	312 €
	Për paditësin / të paditurin e dytë:	50%	360 €	108 €	468 €
	Për paditësin / të paditurin e tretë:	50%	480 €	144 €	624 €
	Për paditësin / të paditurin e katër:	50%	600 €	180 €	780 €
	Për paditësin / të paditurin e pestë:	50%	720 €	216 €	936 €
<i>Përpilimi i kërkesave në procedurë administrative / padive në konflikte administrative dhe përgjigjeve, pa vlerë të caktuar monetare</i>	Për paditësin / të paditurin e parë:		320 €	96 €	416 €
	Për paditësin / të paditurin e dytë:	50%	480 €	144 €	624 €
	Për paditësin / të paditurin e tretë:	50%	640 €	192 €	832 €
	Për paditësin / të paditurin e katër:	50%	800 €	240 €	1,040 €
	Për paditësin / të paditurin e pestë:	50%	960 €	288 €	1,248 €

PROCEDURA NË GJYKATËN KOMERCIALE DHE NË DHOMËN E POSAÇME

<u>Referuar nr. tarifor 6.2 dhe nr. 10</u>		mbi një palë	Baza	Paushall i 30 %	Gjithsejtë
<i>Përpilimi i padive, propozimeve, prapësimeve, përgjigjeve</i>	Për paditësin / të paditurin e parë:		500 €	150 €	650 €
	Për paditësin/të paditurin e dytë:	50%	750 €	225 €	975 €
	Për paditësin/të paditurin e tretë:	50%	1,000 €	300 €	1,300 €
	Për paditësin/ të paditurin e katër:	50%	1,250 €	375 €	1,625 €
	Për paditësin/ të paditurin e pestë:	50%	1,500 €	450 €	1,950 €

PROCEDURA PËMBARIMORE - PËRPILIMI I PARASHTRESAVE

Lloji i parashtresave	Vlera e çështjes		Baza	Klauzul .	Paushall i	Gjithsejtë:
				50%	30%	
<i>Përmbarrim në bazë të titullit përmbarrimor me vlerë deri në lartësinë e kontestit të vlerës së vogël</i>			120 €	60 €	54 €	234 €
Për kreditorin dytë / debitorin e dytë:		50%	180 €	90 €	81 €	351 €
Për kreditorin tretë / debitorin e tretë:		50%	240 €	120 €	108 €	468 €
Për kreditorin katërt / debitorin e katërt:		50%	300 €	150 €	135 €	585 €
Për kreditorin pestë / debitorin e pestë:		50%	360 €	180 €	162 €	702 €
<i>Përmbarrim në bazë të titullit përmbarrimor me vlerë mbi lartësinë e kontestit të vlerës së vogël</i>			160 €	80 €	72 €	312 €
Për kreditorin dytë / debitorin e dytë:		50%	240 €	120 €	108 €	468 €

Për kreditorin tretë / debitorin e tretë:	50%	320 €	160 €	144 €	624 €
Për kreditorin katërt / debitorin e katërt:	50%	400 €	200 €	180 €	780 €
Për kreditorin pestë / debitorin e pestë:	50%	480 €	240 €	216 €	936 €
Përmbnim në bazë të titullit përmbnimor me vlerë 10.000, € e më lartë		320 €	160 €	144 €	624 €
Për kreditorin dytë / debitorin e dytë:	50%	480 €	240 €	216 €	936 €
Për kreditorin tretë / debitorin e tretë:	50%	640 €	320 €	288 €	1,248.00 €
Për kreditorin katërt / debitorin e katërt:	50%	800 €	400 €	360 €	1,560.00 €
Për kreditorin pestë / debitorin e pestë:	50%	960 €	480 €	432 €	1,872.00 €
Përmbnim në bazë të titullit përmbnimor me vlerë 100.000, € e më lartë		500 €	250 €	225 €	975 €
Për kreditorin dytë / debitorin e dytë:	25%	625 €	312,50 €	281,25 €	1.218,75 €
Për kreditorin tretë / debitorin e tretë:	25%	750 €	375 €	337,50 €	1.462,50 €
Për kreditorin katërt / debitorin e katërt:	25%	875 €	437,50 €	393,75 €	1.706,25 €
Për kreditorin pestë / debitorin e pestë:	25%	1,000.00 €	500 €	450 €	1,950.00 €
Përmbnim në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë deri në lartësinë e kontestit të vlerës së vogël		120 €		36 €	156 €
Për kreditorin dytë / debitorin e dytë:	50%	180 €		54 €	234 €
Për kreditorin tretë / debitorin e tretë:	50%	240 €		72 €	312 €
Për kreditorin katërt / debitorin e katërt:	50%	300 €		90 €	390 €
Për kreditorin pestë / debitorin e pestë:	50%	360 €		108 €	468 €
Përmbnim në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë mbi në lartësinë e kontestit të vlerës së vogël		160 €		48 €	208 €
Për kreditorin dytë / debitorin e dytë:	50%	240 €		72 €	312 €
Për kreditorin tretë / debitorin e tretë:	50%	320 €		96 €	416 €
Për kreditorin katërt / debitorin e katërt:	50%	400 €		120 €	520 €
Për kreditorin pestë / debitorin e pestë:	50%	480 €		144 €	624 €
Përmbnim në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë 10.000,00 € e më lartë.		320 €		96 €	416 €
Për kreditorin dytë / debitorin e dytë:	50%	480 €		144 €	624 €
Për kreditorin tretë / debitorin e tretë:	50%	640 €		192 €	832 €
Për kreditorin katërt / debitorin e katërt:	50%	800 €		240 €	1,040.00 €
Për kreditorin pestë / debitorin e pestë:	50%	960 €		288 €	1,248.00 €
Përmbnim në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë 100.000 € e më lartë		500 €		150 €	650 €
Për kreditorin dytë / debitorin e dytë:	25%	625 €		187,50 €	812,50 €

Për kreditorin tretë / debitorin e tretë:	25%	750 €		225 €	975 €
Për kreditorin katërt / debitorin e katërt:	25%	875 €		262,50 €	1.137,50 €
Për kreditorin pestë / debitorin e pestë:	25%	1,000.00 €		300 €	1,300.00 €

PËRFAQËSIMI NË PROCEDURË CIVILE DHE TË TJERA					
Lloji i çështjes juridike dhe vlera		Baza	30 % ora	Paush 30%	Gjithsejtë:
Përfaqësimi në konteste të vlerës së vogël		120 €	36 €	46,80 €	202,80 €
Për paditësin / të paditurin e dytë:	50%	180 €	54 €	70,20 €	304,20 €
Për paditësin / të paditurin e tretë:	50%	240 €	72 €	93,60 €	405,60 €
Për paditësin / të paditurin e katër:	50%	300 €	90 €	117,00 €	507,00 €
Për paditësin / të paditurin e pestë:	50%	360 €	108 €	140,40 €	608,40 €
Përfaqësimi në konteste që vlera e kontestit Mbi vlerën e kontestit të vogël e deri në 10.000 €		160 €	48 €	62,40 €	270,40 €
Për paditësin / të paditurin e dytë:	50%	240 €	72 €	93,60 €	405,60 €
Për paditësin / të paditurin e tretë:	50%	320 €	96 €	124,80 €	540,80 €
Për paditësin / të paditurin e katër:	50%	400 €	120 €	156,00 €	676,00 €
Për paditësin / të paditurin e pestë:	50%	480 €	144 €	187,20 €	811,20 €
Përfaqësimi në kontestet me vlerë mbi 10.000 € e më lartë		320 €	96 €	124,80 €	540,80 €
Për paditësin / të paditurin e dytë:	50%	480 €	144 €	187,20 €	811,20 €
Për paditësin / të paditurin e tretë:	50%	640 €	192 €	249,60 €	1.081,60 €
Për paditësin / të paditurin e katër:	50%	800 €	240 €	312,00 €	1.352,00 €
Për paditësin / të paditurin e pestë:	50%	960 €	288 €	374,40 €	1.622,40 €
Përfaqësimi në kontestet me vlerë mbi 100.000 € e më lartë		500 €	150 €	195,00 €	845,00 €
Për paditësin / të paditurin e dytë:	25%	625 €	187,50 €	243,75 €	1.056,25 €
Për paditësin / të paditurin e tretë:	25%	750 €	225,00 €	292,50 €	1.267,50 €
Për paditësin / të paditurin e katër:	25%	875 €	262,50 €	341,25 €	1.478,75 €
Për paditësin / të paditurin e pestë:	25%	1,000.00 €	300,00 €	390,00 €	1.690,00 €

Pjesë përbërëse e Tarifës:

1. Në rastet kur subjekti juridik i avokatit, është i regjistruar në TVSH, ky tatim i shtohet mbi shumën totale të përcaktuar me këtë rregullore.
2. Për përpilimin e parashtresave dhe përfaqësim në seanca për çështje civile te arbitrazhes si dhe kontesteve me element te huaj, zbatohet rritje për 100% e numrit tarifar 6 dhe 7.
3. Në bazë të kësaj rregullore avokati me klientin e tij mundet që të kontraktoj shpërblimin për punën e tij, përjashtimisht shumave të cekura në formë tabelare, edhe sipas marrëveshjes së lirë me klientin (në bazë të kontratës së lidhur).
4. Për përpilimin e kërkesave, padive, propozimeve, ku janë të përfshira dy e më shumë kërkesa në mënyrë komulative në atë akt, avokatit i takon shpërblimi edhe 50% të tarifës shtesë nga shuma e caktuar për përpilimi të këtyre akteve inicuese të procedurës.
5. Për përpilimin e mjeteve juridike në procedurat civile dhe tjera, avokatit i takon e drejta e shpërblimit të shumës së dyfishuar nga shuma e përcaktuar për përpilimin e kërkesës, padisë apo prapësimit.
6. Për veprimet e avokatit në procedurën kundërvajtëse apo disiplinore, shpërblimi llogaritet analogjikisht si për veprimet me bazë tarifore prej 120 €.
7. Për përpilimin e kontratave, ujdive, testamentit avokatit i takon shpërblimi sipas nr. tarifar 6. apo deri në 1 % të vlerës së tregut të pasurisë që është objekt i punës juridike përkatëse - nr. tar. 12.
8. Për të gjitha shpërblimet për punën e avokatit që nuk janë përfshir në këtë formë tabelare dhe pjesës përbërëse, avokati ka të drejtën e shpërblimit, sipas kësaj rregullore.